



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2588/3 Prot.

Tiranë, më 28/10 2025

V E N D I M

Nr. 141 datë 28.10. 2025

**“PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË NDRYSHIMEVE TË RREGJISTRIT TË
PARASHIKIMEVE PUBLIKE (NGA TË ARDHURAT) PËR VITIN 2025,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor IAL, në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, 108, në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 127, në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në Vendimin e BA nr.17 datë 07.03.2025 “Për miratimin e shtesave të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike (nga buxheti dhe të ardhurat) për vitin 2025, në UST”, mbështetur në Vendimin e Rektoratit nr. 124 datë 17.10.2025, në Vendimin e SA nr. 132 datë 20.10.2025, në Vendimin e BA nr. 56 datë 22.10.2025 “Të miratojë përfundimin e plotë të objektit ‘Rikonstruksion i fushës së futbollit dhe pistës së atletikës dhe rrethimi në Universitetin e Sporteve të Tiranës’ sipas projektit dhe shtesës së preventit të ripunuar”, në shkresën e Mbikqyrësit të punimeve nr. 506 datë 24.10.2025 protokolluar në UST me nr. 1799/87., datë 24.10.2025 me subjekt “Kërkesë”, në shkresën e Grupit të Zbatimit të Kontratës nr. 1799/88 datë 27.10.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.10.2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin e ndryshimit të Rregjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike (nga të ardhurat) për vitin 2025 në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas tabelës bashkëngjitur.
1. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST-së.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.Dr. AGRON KASA

